

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“KURTI LEGAL OFFICE” SHPK**

Sot, më datë 01.03.2024 (Dymijë e njëzet e katër), ortaku themelues:

1. **Z. Shpëtim Kurti** -shtetas shqiptar, i biri i Muratit lindur në Nikoliq, i datëlindjes 20.04.1972, me banim në adresen: Rruga: M. Fortuzi, Pall. V. Kushi, Nd.20, Ap.18, Tiranë, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit me Nr. Personal H20420253D.

Kanë vendosur themelimin e shoqërisë “Kurti Legal Office” shpk me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare “Kurti Legal Office” shpk themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (këtu e më poshtë Shoqëria). Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

**NENI 2. Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin juridik-civil me emërtimin e saj “Kurti Legal Office” SHPK.

**NENI 3. Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtem:

**Shoqëria ka për objekt ushtrimin** : Avokat. Këshillim ligjor të personave fizikë dhe juridikë Përfaqësim në procesin penal, civil, administrativ ose të ndonjë natyre tjetër që mund të mos përfshihet në këto tri kategori, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda ose jashtë vendit, pranë gjykatave ndërkombëtare ose të çdo organizmi tjetër pranë të cilit Republika e Shqipërisë ka aderuar, si dhe të përfaqësimit në procedurat e ndërmjetësimit të arbitrazhit. Hartimi i akteve juridike dhe çdo akti tjetër sipas kërkesave të personave fizikë ose juridik, vendas apo të huaj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Veprime të tjera të parashikuara në legjislacionin shqiptar ose në legjislacionin e huaj, kur veprimtaria kryhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

**NENI 4 Selia e Shoqërisë**

- 4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresën: - Rruga Mine Peza, Pallati 43/7, Kati i parë.
- 4.2 Adresa e selise mund të ndryshohet me vendim të Asamblese së Ortakeve të Shoqërisë.


**NENI 5. Kapitali i Shoqërisë**

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i ortakeve themelues të kësaj Shoqërie në lekë.

Kontributi në para do të jetë i përbërë nga shuma prej 100,000 (njëqindmijë) Lekë, i ndarë në **1(një)** kuota .

Ortakët themelues të shoqërisë, i zotërojnë kuotat në shoqëri si më poshtë:

KURTI LEGAL OFFICE  
AKT THEMELIMI



- **Shpëtim Kurti** – Zotërues i 1(një) kuote që përfaqson 100% te kapitalit të shoqërisë me vlerë 100,000 (njëqindmijë) lekë.

Kapitali themeltar është derdhur tërësisht nga ortakët themelues. Vlera dhe pagesa e e kapitalit themeltar do të kryhet në momentin e nënshkrimit të këtij statuti dhe aktit të themelimit.

#### **NENI 6. Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një afat të pacaktuar.

#### **Neni 7. Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve - organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori - organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administrator i pare i shoqërisë do të jetë Shpëtim Kurti - shtetas shqiptar, i biri i Murtatit, lindur në Nikoliq, i datelindjes 20.04.1972 me banim në adresen: Rruga M.Fortuzi, Pallati V.Kushi , Nd.20, Ap.18 Tirane ,mbajtës i leternjoftimit me nr. personal H20420253D me një mandat 5 (pesë) vjeçar.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 8**

Ekspërti Kontabël i Autorizuar i shoqërisë do të emërohet në përputhje me me legjislacionin përkatës në fuqi dhe për çdo vit financiar shoqëria do të emërojë një ekspert kontabël për të kontrolluar aktivitetin ekonomik të shoqërisë.

#### **NENI 9**


Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 10**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 11**

KURTI LEGAL OFFICE  
AKT THEMELIMI



Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

**NENI 12. Legjislacioni i aplikuar**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortakët themelues dhe i vulosur përpara noterit, në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

**NENI 13. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**


Mosmarrveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve apo ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

**NENI 14. Dispozita Përfundimtare**

Akti i themelimit përpilohet në 4 (katër) kopje të njëjta në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet pa vërejtje nga ortakët themelues.

**ORTAKËT THEMELUES**

**1. Shpëtim KURTI**

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Shpëtim Kurti', written over a horizontal line. Below the line, there are several large, sweeping loops and flourishes.